UNIVERSITETI
I SHKENCAVE TË APLIKUARA
FERIZAJ

UNIVERSITETI I SHKENCAVE TË APLIKUARA NË FERIZAJ
UNIVERSITY OF APPLIED SCIENCES IN FERIZAJ
Njësia Org. / Org. Unit: /
Nr. Prot: 4400/26 / Prot. No: 4400/26
Nr. i faqeve / No. pages: 2
Data: 23/11/2026 / Date: 23/11/2026

Nr. Prot.:4400/26; Datë: 23.11.2026

Në bazë të vendimit nr. 648/26, të datës 30.03.2026 të Këshillit Drejtues, Universiteti i Shkencave të Aplikuara në Ferizaj (UShAF), me datën 23.11.2026 shpallë:

KONKURS

për ndarjen e bursave universtare për studentë, për vitin akademik 2026/27

I.
Kushtet e përgjithshme

1. Bursa universitare ndahet për studentët e nivelit të studimeve themelore (bachelor) dhe nivelit të studimeve master;

2. Të drejtë aplikimi për bursë kanë studentët e UShAF, të cilët i plotësojnë këto kushte:

   - Të jenë studentë të rregullt të Fakulteteve të UShAF;
   - Të jenë studentë të vitit të dytë e më lartë (bachelor) dhe student të vitit të dytë të nivelit master;
   - Të mos kenë vit të përsëritur të studimeve;
   - Ti kenë të dhëna të gjitha provimet e vitit paraprak të studimeve në afatin e shtatorit 2026;
   - Të kenë notë mesatare të studimeve 8.00 (tetë pike zero) e më lartë.

II.
Dokumentacioni i nevojshëm për aplikim

1. Studentët të cilët i plotësojnë kushtet nga pika një (1) e këtij konkursi, duhet t'I paraqesin këto dokumente:

   - Aplikacioni (i cili merret te Zyra e shërbimit të studentëve);

- Kopjen e leternjoftimit;
- Konfirmimin nga banka për xhirollogarinë bankare, e cila llogari duhet të jete aktive. Llogaria bankare duhet të jetë e vet studentit që aplikon.

2. Dokumentet e kompletuara dorëzohen fizikisht në Zyrën e Shërbimit të Studentëve.

- Administrata Qendrore është e obliguar që në përputhje me kriteret e përcaktuara me këtë konkurs, t'i përgatit listat e studentëve të cilët i plotësojnë kriteret për përfitimin e bursës universitare;
- Dokumentacioni i pakompletuar nuk do të pranohet nga Zyra e Shërbimit të Studentëve.

III. Afati per aplikim

1. Afati i aplikimit është prej datës 24.11.2026 deri më 30.11.2026 ora 15:00.

IV. E drejta e ankesës

1. Studentët të cilët konsiderojnë se kanë pasur të drejtë të përfitimit të bursës universitare dhe nuk janë të përfshirë në listën e studentëve përfitues të bursës, kanë të drejtë ankese tek Komisioni Për Ankesa, në afat prej 48 orësh pas ditës së publikimit të listave.

2. Ankesat duhet të dorëzohen në Zyrën e Shërbimit të Studentëve.